REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE , KULLOTAVE DHE MJEDISIT
Projekt-Vendim

Nr.24. Datë21/03/2025

"PËR DHËNIN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PREJ 7.54 HA NE FONDIN PYJOR/KULLOSOR ,PËR INSTALIMIN E PANELEVE ME ENERGJI DIELLORE ,FOTOVOLTAIKE "

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"(I ndryshuar),neni 8 , pika 2 , neni 9 , pika 1 , nenpikat 1.1 , shkronja(b) dhe 1.2 shkronjat "a" dhe "c" , nenit 27 dhe pika 5 , nenit 54 shkronja "e/1" nenit 55 pika3, nenit 64 shkronja"a" dhe "c".Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil I Republikës të Shqipërisë" (I ndyshuar) , Ligjit 57/2020 "Për Pyjet " . "VKM nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave(I ndyshuar) .Vendim nr. 398 , datë 13.5.2020, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive" ", Vendim Nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore,"(I ndryshuar). VKM Nr. 267, datë 27.4.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të këshillit të ministrave, Udhezim Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe në Raportin Tektiko – Ekonomik Nr.Prot 853/1 datë 06/03/2025

Propozoj:

1.Dhënien e miratimit për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 75,400 m^2 (7.54 ha) .Në ngastrën me Kod Kadastral KO02 00 002 ,Ekonomia Kullosore"Bilisht", me qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 7.54 ha ,për vendosjen e Paneleve Fotovoltaike . Bashkëngjitur Raporti Tekniko – Ekonomik Nr.Prot853/1datë06/03/2025 i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit.
2.Akti i dhënies në përdorim do të jetë 10 vjet nga nenshkrimi i kontratës të qirasë .
3.Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 pika 6 të Ligjit .139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" I ndyshuar .

Konceptoi: **Drejtori I Drejtorisë të pyjeve dhe mjedist**

Edmir Cenolli

Konfirmoi: Pergj.Sek Juridik

Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagjia. Nr 1 Rr. 24 Tetori Nr. 5, Tel&Fax +35581122288 E-mail bashkiadevoll@gov.al
web:http://bashkiadevoll.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE MJEDISIT

Nr. 853/1 **Prot** **Bilisht më,** 06.03 **/__/2025**

RAPORT TEKNIK-EKONOMIK

MBI STUDIMIN TEKNIKO EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË DEVOLL

(Për istalimin e paneleve me energji diellore fotovoltaike HP ENERGY)

Bazuar në Urdhërin nr. 242 datë 04.03.2025 me nr.Prot 853 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt i dhënies në përdorim, grupi i punës i përbërë nga Specialist Inxhinier Pyjesh dhe Mjedisi : Orgest Cenolli: Denis Xhuri : Specialist i Kadastrës/GIS: Armaldi Doko nga data 04.03.2025 deri në datën 06.03.2025 studio kërkesën e subjektit HP Energy SHPK dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objekt i dhënies në përdorim. Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor / kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 7.54 ha , dhe shtrihet nw ngastrën 002 , e cila bën pjesë në Ekonominë Kullosore " Bilisht " dhe është ne pronësi / administrim të Bashkisë Devoll. Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohet në aneksin 1 të këtij raporti . Nga verifikimi në terren rezulton gjëndja : Nuk ka ndryshime në terren te ngastrës .
Ndërhyrjete e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria , HP Energy SHPK nuk ndyshojnë kategorinë e përdorimit por jepen në përdorim më afat 10 vjecar .

Proçedura që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-në nr 1353, datë 10.10.2008 të ndryshuar, "Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës , mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik . Kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor," në V.K.M-në nr 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", në Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat , proçedurat e kërkimit , të shqyrtimit e të miratimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik." . Vendim Nr . 559 , date 29.07.2022 " Për përcaktimi e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar , për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore"

Shtojca Nr 1 "Për tarifat e dhenies ne përdorim e fondit pyjor kombetar për veprimtarite e ushtruara ne kete fond" *Lidhja Nr 8 ;11 .*

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër , shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur , vetëm pas lidhjes së kontratës me **Bashkinë Devoll** dhe likujdimin të tarifës prej **1,328,040 lekë/vit.**

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave", të ndryshuar me VKM-në 1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave" "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", Vendim Nr . 559 , date 29.07.2022 " Për përcaktimi e cmimeve dhe tarifave për dhenin ne shfrytëzim përdorim te fondit pyjor kombëtar , për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore". Shtojca Nr 1 "Për tarifat e dhenies ne përdorim e fondit pyjor kombetar për veprimtarite e ushtruara ne kete fond" *Lidhja Nr 8;11 .*

a) Vlerën e përdorimit e sipërfaqes lek/ha/vit 1,327,040 lekë.

Trungishte _____ha x_____ _ lek = _____ lekë.
Cungishte ha x lek= lekë.
Shkure ha x _____ lek = _____ lekë.
Kullotë **7.54** ha x 176.000 lek = 1,327,040 lekë
Inproduktive etj __ha x_____ lek = _____lekë.

b) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km/vit lekë.

Trungishte	km x	lekë =	lekë.
Cungishte	km x	lekë =	lekë.
Shkure	km x	lekë =	lekë
Kullotë	km x	lekë =	lekë
Inproduktive etj	km x	lekë =	lekë.

c) Tarifa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar në fondin pyjor/kullosor .

1. Vlera e lëndës së punimit _____-_____ lekë.
2. Vlera e druve të zjarrit _____-_____ lekë.
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore _____-_____ lekë.
4. Kullotja ___ 1,000 ___ lekë.
5. Vlera e faunës _____-_____lekë.
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zvëndësime, përmirësime, etj _-_ lekë.
7. Të tjera _____-_____ lekë.

PËRPILUSIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Specialist i Inxhinier Pyjesh dhe Mjedisi

Denis Xhuri

Specialist i Kadastrës/GIS

Armaldi Doko

Drejtor i Drejtorie

Edmir Cenolli

Përgjegjësi i Sektorit

Orgest Cenolli

KRYETARI I BASHKISË
Eduard DURO

Adresa: Lagjia Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
web:http://bashkiadevoll.gov.al/